



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 07.08.2019, ora 09.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Shpallja e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve në vendet vakante të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

2. Shpallja e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

3. Përcaktimi i kalendarit të intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim në vendet vakante të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

4. Miratimi i ekspertëve të gjuhëve të huaja në funksion të realizimit të intervistave me kandidatët e lejuar.

5. Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës dhe zhvillimi i intervistës, sipas ligjit, me kandidatin Besnik Muçi, i kandiduar për vende vakante në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Marrin pjesë :

- | | |
|-------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 4. Fatjona Memçaj | (anëtar) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se anëtarët e Këshillit, zonja Arta Marku dhe zonja Margarita Buhali, sipas njoftimeve përkatëse, për shkaqe objektive shëndetësore e kanë të pamundur të marrin pjesë në mbledhjen e sotme.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shpallja e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve në vendet vakante të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

Shpallja e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Përcaktimi i kalendarit të intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim në vendet vakante të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Miratimi i ekspertëve të gjuhëve të huaja në funksion të realizimit të intervistave me kandidatët e lejuar.

Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës dhe zhvillimi i intervistës, sipas ligjit, me kandidatin Besnik Muçi, i kandiduar për vende vakante në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se në lidhje me dy pikat e para të rendit të ditës, projektvendimi i parë për shqyrtim dhe miratim lidhet me “fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve për vendet vakante”. Kanë përfunduar procedurat e verifikimit për të gjithë kandidatët, për të gjitha vendet vakante, si për Gjykatën Kushtetuese ashtu edhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Sipas përcaktimeve të ligjit, por edhe të akteve nënligjore normative të Këshillit, në përfundimin të procedurave të verifikimit dhe dhënies së vendimeve për lejimin ose ndalimin e kandidimit për të gjithë kandidatët dhe për të gjitha vendet vakante, thirrret mbledhja e Këshillit për të vendosur lidhur me fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes.

Meqenëse ende nuk është konkluduar në lidhje me gjendjen e krijuar nga numri më i vogël se minimumi i kandidaturave për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për dy vende vakante, vakanca të parakohshme për në Gjykatën Kushtetuese propozohet, si varianti më i mirë, që në këtë mbledhje të miratohet projektvendim vetëm për fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve të lejuar për katër vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, vendi vakant me mandat të plotë i shpallur nga Presidenti në datën 7 shkurt 2018, vendi vakant me mandat të plotë i shpallur nga Kuvendi në 12 shkurt 2018, vendi vakant me mandat të plotë shpallur nga Presidenti në datën 4 mars 2019 dhe vendi vakant me mandat të plotë shpallur nga Kuvendi në 4 mars 2019. Në lidhje me tre vendet e tjera vakante do të vendoset në mbledhjen e ardhshme.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe e miratojnë me votë unanime këtë projektvendim sipas variantit të propozuar për fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar vetëm për katër vende vakante me mandat të plotë në Gjykatën Kushtetuese, dy të shpallura nga Presidenti (në datat 07.02.2018 dhe 04.03.2019) dhe dy të shpallura nga Kuvendi (në datat 12.02.2018 dhe 04.03.2019).

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se në lidhje me pikën e katërt të rendit të ditës propozohet për shqyrtim dhe miratim, sipas përcaktimeve të ligjit dhe aktetve nënligjore normative të KED, projektvendimi për caktimin e ekspertëve të gjuhëve të huaja në funksion të realizimit të intervistave me kandidatët e lejuar për verifikimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja nga kandidatët e lejuar. Për këtë qëllim propozohen dy pedagoge të brendshme të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, Doktore e Shkencave Adelina Brahimë nga Departamenti i Gjuhës Angleze dhe Professore Aida Gjinari nga Departamenti i Gjuhës Italiane meqenëse ka një kandidat që ka përzgjedhur gjuhën Italiane dhe me mundësi edhe një tjetër kandidate në varësi të vendimarrjes pasuese të kësaj mbledhjeje.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe e miratojnë me votë unanime projektvendimin për caktimin e Dr. Adelina Brahimë nga Departamenti i Gjuhës Angleze dhe Prof. Aida Gjinari nga Departamenti i Gjuhës Italiane si eksperte për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja, të deklaruara nga kandidatët e lejuar për vendet vakante.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se në lidhje me pikën e tretë të rendit të ditës propozohet për shqyrtim dhe miratim, sipas përcaktimeve të ligjit dhe të rregullave tona normative, përcaktimi i kalendarit të intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim në vendet vakante. Meqenëse me vendimin e parë të ditës së sotme është miratuar fillimi i procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar vetëm për katër vende vakante me mandat të plotë në Gjykatën Kushtetuese, propozohet që të riformulohet projektvendimi dhe në kalendarin e intervistave, që do të zhvillohen në datën 09.08/2019, të vendosen fillimisht njëri pas tjetrit në rend alfabetik gjashtë kandidatët e lejuar për këto katër vende vakante, ndërsa koha e intervistës së mundshme me tre kandidatët e tjerë të lejuar vetëm për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të vendoset në vijimin të tyre, në varësi të vendimarrjes së mbledhjen e ardhshme të datës 09.08.2019.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe e miratojnë me votë unanime projektvendimin për miratimin e kalendarit të intervistave me kandidatët e lejuar për vendet vakante.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se sipas rendit të ditës dhe vendimeve që sapo janë miratuar, kalohet menjëherë në relatimin dhe zhvillimin e intervistës me kandidatin e lejuar Besnik Muçi, i cila kandidon për tre vende vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

KED me vendimet nr 70, 71 dhe 72 të datës 24.07.2019 ka vendosur lejimin e kandidimit te kandidatit Besnik Muçi për gjyqtar ne Gjykatën Kushtetuese, në tre vende vakante. Për rrjedhojë në bazë të Kushtetutës neni 125, pika 4 dhe 5, nenit 7a te ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, dispozitave të neneve 228 pika 4, 239, 240 e që janë dhe më specifike të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, por edhe pikat 36 dhe 38 të vendimit normativ të KED me nr.5/2019 që lidhet me kriteret dhe procedurat pikëzimit te përzgjedhjes se kandidatëve. Është përgatitur edhe relacioni ku përshkruhen të dhënat faktike që lidhen me vjetërsinë, notën mesatare, në lidhje me titujt dhe gradat shkencore, listimi i llojeve të trajnimeve që ka ndjekur kandidati, listën e punimeve profesionale, punimeve shkencore që ai ka paraqitur për efekte të vlerësimit, dokumente për deklarimin e kandidatit për njohurin e gjuhëve të huaja, dokumentet e përzgjedhura nga vetë kandidati për vlerësim në mënyrë më të posaçm, si edhe tregohet lista e angazhimeve shtesë profesionale. Në rastin e kandidatit Besnik Muçië duke qenë edhe magjistrat janë edhe shkresat e sjella nga Prokuroria e Përgjithshme apo nga KLP të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin e punës së prokurorit. Ka pasur tre vlerësime në të kaluarën. Dokumentacioni është i njëjtë për të tre kandidimet e tij, pavarësisht nga vendi vakant në Gjykatën Kushtetuese. Ka material voluminoz për punime shkencore, certifikata dhe vërtetime qe lidhen me dokumentacionin e paraqitur.

Sipas procedurës së parashikuar në pikën 53 të vendimit normativ të KED me nr.5/2019, përpara se të thiret kandidati, verifikohet paraqitja në cilësinë e ekspertit të pedagoges së përzgjedhur nga Këshilli për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja nga kandidati Besnik Muçi, Dr. Adelina Brahim.

Thirret ekspertja Dr. Adelina Albrahimi.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon mbledhjen dhe ekspertin Dr.Adelina Albrahimi se, nëpërmjet komunikimit i janë bërë të ditura ekspertes natyra e këtij procesi, mbi çfare rregulla organizohet, cila është rëndësia e detyrës, të cilën ne e vlerësojmë shumë që e pranuat për ta ushtruar. Bëhet fjalë për një nga komponentët e vlerësimit, për nivelin e zotërimit të gjuhëve te huaja. Sigurisht në këtë proces përzgjidhet gjyqtar për Gjykatën Kushtetuese, por për ushtrimin e detyrës me mirë e me një nivel më të lartëprofesional edhe niveli i zotërimit të

gjuhëve të huaja. Sidomos atyre erupiane perëndimore, do të ishte një vlerë e shtuar. Edhe ligji e parashikon si kriter vlerësues nivelin e njohurive në gjuhët e huaja, madje parashikon edhe që Këshilli mund të marrë në cilësinë e ekspertëve ata të fushës së gjuhëve të huaja të cilët të japin mendimet e tyre me shkrim në fund, pasi bëhet intervista. Intervista zhvillohet me gojë. Nuk është një testim me shkrim, sipas normave që kemi miratuar, bëhet në trajtën e një bisede. Ju jeni eksperte dhe e dini më mirë se sa ne natyrën dhe trajtën e bisedës dhe mënyrën se si do ta zhvilloni. Nuk kemi përcaktuar një kohëzgjatje, mund të 10 minuta apo aq sa ju mendoni që është e nevojshme për të nxjerr ato të dhëna që nevojiten sipas standardeve të vlerësimit të cilat edhe KED i ka cituar në Metodologjinë e tij. Pak a shumë kjo është natyra e intervistës. Ju keni metodat tuaja për ta testuar dhe pas mbarimit të intervistës do të na jepni një mendim me shkrime. Kemi besim që do ta kryeni më së miri detyrën tuaj. Kandidatet e Gjykatës Kushtetuese kanë 3 pikë, kandidatet e për inspektor nëse ne do te procedojmë ditën e premte me ta, kanë 2 pikë. Vërtet KED nuk është gjykatë por duke qenë në cilësinë e një eksperti, kemi një formulë betimi, e cila i lexohet ekspertit, pasi e dëgjon, ftohet të betohet.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon formulën e betimit për ekspertin: “I vetëdijshëm për përgjegjësinë morale dhe ligjore për detyrën që marr përsipër, do ta kryej bazuar në standardet profesionale, me ndershmëri e drejtësi dhe do të ruaj konfidencialitetin për të gjitha të dhënat që lidhen me ekspertimin”,

Ekspertja Adelina Brahimi, pasi dëgjoji formulën e betimit, deklaroi “Betohem”.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon ekspertin se sipas rregullave që kemi miratuar në procedurën tonë, bëhet me dije se kandidati që intervistohet është z. Besnik Muçi, aktualisht Prokuror në prokurorinë e Krimeve të Rënda.

Pyetet ekspertja Dr. Adelina Albrahimi nëse e njeh dhe a është në marrëdhënie papajtueshmërie apo konflikti interesi me kandidatin Besnik Muçi?

Ekspertja Adelina Brahimi, deklaroi që nuk kam shkak papajtueshmërie apo konflikt interesi me kandidatin Besnik Muçi.

Thirret kandidati Besnik Muçi për zhvillimin e intervistës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon zotin Besnik Muçi se ju jeni kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për tre vende vakante. Sigurisht ju jeni i njohur me procedurat që parashikon ligji dhe aktet normative që ka miratuar KED lidhur me procedurën e verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për ILD. Krahas të gjithë

procedurës së ndjekur deri më sot për verifikimin e kandidaturës tuaj, për të cilën ju jeni në dijen që Këshilli ka lejuar kandidimet tuaja. Faza tjetër, e cila zhvillohet nga sot në rastin tuaj, është ajo e procedurës së vlerësimit të kandidaturës tuaj. Krahas dokumentacionit që ju keni vlerësuar të paraqisni para KED-së për efekt të vlerësimit dhe meritave tuaja profesionale, morale dhe administrative që iparashikon ligji apo të disa dokumenteve që Këshilli ka çmuar të tërheq në rastin e vlerësimit të kandidaturës tuaj, është edhe kjo pjese e procedurës që ka të bëjë me intervistën dhe bisedën e KED-së me kandidatet. Në rastin konkret, kjo procedurë që behet për herë të parë nga Ky këshill do të fillojë me ju.

Sigurisht që kjo intervistë nuk është e pa limituar në kohë, Do të përpiqemita administrojmë në mënyrën më të mirë dhe të mençur. Fakti që nuk është e pa limituar në kohë nuk do të thotë që juve do tju ngushtohet hapësira për t' shprehur motivimin tuaj për këtë kandidim, por, gjithsesi, do ta menaxhojmë këtë proces në vijim.

Fillimisht duam t' u pyesim nëse vëreni situata papajtueshmërie apo konflikti interesi me anëtarët e Këshillit. Përbërjen e Këshillit ju e njihni. Përveç anuarve të Këshillit, të pranishëm janë zj. Avokate e Popullit që ju e njihni dhe përfaqësuesi i Presidentit të Republikës z. Bledar Dervishaj.

Kandidati Besnik Muçi deklaron se nuk konstaton asnjë situatë papajtueshmërie apo konflikt interesi me anëtarët e Këshillit dhe të tjerët.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidatin edhe se Këshilli ka miratuar dhe ka marrë vendim që, në cilësinë e ekspertit për njohuritë e gjuhëve të huaja, në rastin tuaj ju keni përzgjedhur gjuhën angleze, të jetë ekspertja Adelina Brahimi dhe do tu pyesim të njëjtën gjë, nëse vëreni situata te papajtueshmërie apo konflikt interesi me të.

Kandidati Besnik Muçi deklaron se nuk kam situata t papajtueshmërisë apo konfliktit të interesit me të.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidatin se për të vijuar intervistën, në fillim ju keni kohën tuaj për të prezantuar atë që ne e quajmë motivimin e kandidimit dhe me pas biseda do të vijojë pyetje nga ana e anëtarëve të Këshillit.

Kandidati Besnik Muçi merr fjalën dhe lexon përmbledhjen e platformës dhe të vizionit të kandidimit.

Kandidati Besnik Muçi në përfundim të parashtrimit të tij, e depoziton materialin me shkrim para Këshilli.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidatin se në vijim do të ketë pyetje nga ana e anëtarëve të Këshillit. Pyetjen e parë poja u drejtoj unë, ju jeni kolegu jon por ne profilin prokuror dhe keni një kohe shumë të gjatë që ushtroni detyra të ndryshme të rëndësishme në hierarkinë e sistemit të prokurorisë në Shqipëri.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani vijon duke u shprehur se pyetjen e parë po e shtron vetë: Ju jeni kolegu jonë, në profilin prokuror dhe keni një kohë shumë të gjatë që ushtroni detyra të ndryshme e të rëndësishme në sistemin e prokurorisë në Shqipëri. A mund të na e shpjegoni në mënyrë të përmbledhur se si e mendoni ju që përzgjedhja juaj si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese do të kontribuonte dhe çfarë vlere të shtuar do ti jepte një prokuror të qenit anëtar i Gjykatës Kushtetuese?

Kandidati Besnik Muçi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se në fakt është një pyetje që unë ia kame bërë vetes që në momentin që kam menduar të kandidoj, nga momenti që kam paraqitur kërkesën. A mundem unë që me profilin e punës time, me formimin tim të mund të jap një kontribut, të jap një dobi, të jap një vlerë në funksionin që unë pretendoj? Duke pasur në konsideratë faktin që vetë ligji parashikon që edhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të kenë një diversifikim të karrierave të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke pasur shumë në konsideratë dhe faktin që funksioni i prokurorit, pavarësisht se ne, në pamjen e parë duket se ka pak lidhje me elementet e natyrës kushtetuese, por funksioni i prokurorit është i lidhur drejtpërsëdrejti me atë që përbën, në vlerësimin tim, thelbin e Kushtetutës demokratike të një vendi, me liritë dhe të drejtat e njeriut. Vetë procesi penal, Kushtetuta jonë në vlerësimin tim, natyrisht është e sigurt dhe bën një mbrojtje të plotë nga pikpamja e burimit kushtetues të së drejtës, të lirive dhe të drejtave të njeriut, me një standard shumë të lartë e që është në përputhje me standardet e vendeve dhe vlerave euro atlantike ku ne synojmë të antarsohemi. Gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit, një prokuror është i detyruar që të respektoj maksimalisht liritë dhe të drejtat e njeriut. Dhe vetë Kodi i Procedurës Penale është një zbrërthim në vetvete i procesit të rregullt gjyqësor, i cili është veshja, një veshje shumë e rëndësishme e lirive dhe të drejtave të njeriut në procesin penal. Pra liritë kryesore, themelore të të pandehurit në një proces penal, liritë dhe të drejtat e viktimës me ndryshimet e fundit të K. Pr. Penale, ne kemi futur një koncept shumë të rëndësishëm, por në zbatim të gjithë jemi të përditësuar, për konceptin e lirive dhe të drejtave të viktimës në procesin penal. Respektimi në të gjitha fazat e procesit të të drejtave, të cilat janë se pari të drejta kushtetuese dhe janë edhe të drejta procedurale penale, është obligimi themelor i

një prokurori. E marrë në kuptimin e ngushtë profesional të karrierës së një prokurori vlerësoj që çështje kaq të rëndësishme për një demokraci për zbatimin me korrektesë të Kushtetutës janë çështje të rëndësishme edhe Gjykatës Kushtetuese dhe një përvojë prokurori vlerësoj që mund ti sjelli dobi Gjykatës Kushtetuese në ushtrim të funksioneve dhe veprimtarisë së saj . Në këtë aspekt vlerësoj që edhe unë, me përvojën time si prokuror, mund të jap kontribut modest në këtë fushë specifike të së drejtës. Pavarësisht kësaj, unë vlerësoj që përveç profesionit tim dhe punës së përditshme, unë vetë personalisht nuk e kam lënë veten të futur n guackën e prokurorit. Gjatë gjithë karrierës time jam munduar dhe kam tentuar të jem aktiv aq sa mund të jem natyrisht, duke marrë pjesë edhe nëpërmjet botimeve, nëpërmjet debateve edhe me natyre kushtetuese. Për shembull, unë gjatë vitit 2015, si të gjithë prokurorët në Republikën e Shqipërisë, shkrova e konceptova në mendjen time se si e mendoja unë, duke pasur parasysh edhe problemet e dala nga raporti i komisionit të ekspertëve në sistemin e drejtësisë, se si mund të ishte prokuroria dhe kur shoh që ligjet e dala, disa edhe nga ato që unë kisha konceptuar gjatë asaj periudhe, janë miratuar të cilat janë ligje komplekse për institucionin e prokurorisë dhe më vjen mirë. Për shembull, unë e kam thënë besoj në dy shkrime që në vitin 2008-2009 që prokuroria shqiptare ndodhej në një konflikt interesi kushtetues. Sepse Kushtetua i jepte prokurorisë shqiptare të drejtën për të ushtruar ndjekje penale dhe prokuroria shqiptare ushtronte kontrollin e ndjekjen penale. Pra për të mos u zgjatur, përveç qëndrimit si prokuror, unë kam tentuar gjatë gjithë karrierës time të shpreh ndonjë mendim për çështje që unë i kam vlerësuar me interes profesional dhe interes publik, gjithmonë duke respektuar etiken e prokurorit dhe profesionin tim, aq sa unë si prokuror mund të shprehesh për çështje thjesht të natyrës shkencore, pa e ndërftuar veten në elementë të tjerë që mund të cenonin profesionin tim. Pra e marrë në kompleks, e marrë në risi dhe vlera për Gjykatën Kushtetuese, prurjet nga profesionet të ndryshme, të lidhura me degë të ndryshme të rëndësishme të së drejtës, gjë që po bëj dhe unë si prokuror.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se në vijim të pyetjes për të cilën sapo dhatë një përgjigje do të doja të evidentoja që Gjykata Kushtetuese ka nevojë për prurje nga specialitete apo fusha të ndryshme të së drejtës sikurse e përcakton ligji. Edhe ju sapo e prezantuat. Po ashtu dhe në relacionin që kemi përpara të bazuar në dokumentacionin tuaj, kemi parasysh që gjithë specializimi juaj në këtë fushë, që nga Shkollën e Magjistraturës dhe të gjitha specializimet e mëtejshme janë të fokusuara në këtë drejtim. Nisur nga kjo, edhe numri i çështjeve penale nga kërkesat që gjykohen nga Gjykata Kushtetuese në gjithë këto vite në raport me çështjet e tjera,

zë një vend shumë të rëndësishëm në vështrimin kushtetues të procesit të rregullt deri këtë periudhë. Po kaq të rëndësishme janë edhe çështjet, madje shumë të rëndësishme, janë edhe çështjet e fushës civile, administrative ku do të veçoja këtu çështjet që lidhen me gjykimet abstrakte apo incidentale në të cilat kontrollohen ligji duke iu referuar parimeve themelore të Kushtetutës. Në këtë kuptim është edhe vijimi i pyetjes që sa po u bë. Si do ta shikonit veten në këtë drejtim? Dhe do ta plotësoja me pyetjen sa jeni ju i gatshëm për të qenë në procesin e vendimmarrjes një bashkëpunues në organet kolegjiale? Sepse çështja e vendimmarrjes si prokuror apo si gjyqtar i vetëm është tërësisht i ndryshëm. Secili vjen me një mendim dhe me kaq vendos, e ka të ndarë mendjen, nisur nga ligji nga faktet. Ndërsa bashkëpunimi në një organ kolegjial është që në momentin e hartimit të projektvendimit, gjatë marrjes së vendimit dhe më pas gjatë proceseve të tjera. Sa jeni ju kontribuues duke iu referuar cilësive që ju keni dhe që sigurisht keni shfaqur ?

Kandidati Besnik Muçi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se edhe në pyetjen e zotit kryetar u përpoqa të argumentoj faktin që përveç të qenit prokuror, natyrisht në karrierën time krahas punës së përditshme, të përplasjeve të përditshme të natyrës kushtetuese në procesin penal gjyqësor ose edhe në trajnime që unë kam kryer si ekspert, qoftë edhe në ato që kam marrë pjesë dhe jashtë vendit, nuk kanë qenë tema të paprekura edhe tema të lidhura me të drejta të tjera, si e drejta civile, e drejta administrative, sikurse ju e cituat më sipër. Edhe unë nuk mund të pretendoj që ekspertiza ime është e njëjtë në fushën e të drejtës civile apo në atë administrative, me ekspertizën që mund të pretendoj mund të kem në fushën e të drejtës penale. Por edhe gjatë formimit tim teorik, si në fakultetin juridik, edhe në atë të Shkollës së Magjistraturës, por edhe gjatë një pjese të karrierës time 2 vjeçare që unë e kam ushtruar si avokat. Natyrisht që unë jam marrë në mënyrë përmbajtjesore me çështjet e natyrës civile të mirëfillte, çështje të natyrës së pronësisë, çështje të natyrës së kontratave. Duke pasur parasysh edhe natyrën e gjykimeve në Gjykatën Kushtetuese, çështjet e interpretimit, çështjet e përputhshmërisë së akteve ligjore dhe nënligjore me Kushtetutën, janë çështje që unë i kam trajtuar, nuk janë çështje që unë nuk i kam pas trajtuar asnjëherë gjatë karrierës time. Por vlerësoj që kontributi në këto lloj çështjesh, duke u nisur nga një ekspertizë e thelluar e një prokurori, duke pasur parasysh edhe faktin që unë prej vitit 2008-2009 jam marrë edhe me atë që quhet ligji anti-mafia, pra kam qenë përveçse pjesë e procesit, unë kam qeni si prokuror që jam marrë me procedurat e ligjit anti-mafia. Në fakt para ndryshimeve të vitit të kaluar, procedura e gjykimin të kërkesës që ka të bëjnë me ligjin anti -

mafia ishte i njëjtë me procedurën civile. Pra gjykimi kishte parimet e procesit civil dhe në një farë mënyre na është dashur të adaptohem edhe për shkak të punës e në vazhdimësi edhe me parimet e procesit civil. Pra edhe kjo ka qenë një përvojë në karrierën time e ndryshme nga procesi thjesht penal. Edhe në këtë mënyrë unë vlerësoj që mund të jap një kontribut, mund të sjell një dobi edhe në gjykimin e çështjeve të tjera të natyrave më specifike, pavarësisht se në Gjykatën Kushtetuese pesha e mirëfilltë e çështjeve me natyrë penale është relativisht e konsiderueshme në raport me çështjet e tjera. Natyrisht është e vështirë të flasësh për veten. Por unë gjatë gjithë karrierës time nuk e kam pasur të vështirë të përditësohem me zhvillimet e legjislacionit, jam i gatshëm edhe nëse është e nevojshme për të bërë një rifreskim, nëse do të më jepej mundësia, gjithmonë kjo do të ishte shumë e domosdoshme. Unë ende e kam vullnetin për ta bërë këtë megjithatë kjo është në vlerësimin tuaj. Sa i përket pyetjes së dytë se sa unë mund të marr parasysh nga puna e prokurorit që është pak me natyrë individuale e që ka të bëjë me vendimmarrjen, sa do të jem unë i aftë të punoj në grup, ku puna në grup në një institucion të tillë është një element thelbësor. Unë në aktin e motivimit që e kam dorëzuar edhe me shkrim kam tentuar të jap një shpjegim këtij momenti, pra sa jam i aftë të punoj në grup. Në fakt vetë puna e prokurorit aq sa duket punë individuale për shkak të vendimmarrjes sepse firma në kërkesën për gjykim apo në diskutimin përfundimtar është e prokurorit, është një punë komplekse dhe në grup për të dalë tek rezultati. Pra është e detyrueshme bashkëpunimi im me gjithë agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të hetimit, përveç punës që prokuroria duke qenë deri para disa vitesh organ piramidale, ne ishim të detyruar të konsultoheshim me drejtuesit e prokurorisë, të krijojmë një grup diskutimi për çështje të rëndësishme ose kur kishim probleme të natyrës së interpretimit të ligjit ose të çështjeve të të provuarit. Ne e kemi pasur praktikë sidomos tek krimet e rënda që drejtuesi i prokurorisë, zëvendësdrejtuesit e prokurorisë dhe prokurori i çështjes bënin një debat shumë të detajuar, por edhe kur kishim të bënim me çështjet e interpretimit, edhe kur kishim të bënim me çështjet e të provuarit. Punën e prokurorisë nuk e shoh aq individuale në kompleks, pra në përmbajtjen e vetë punës së një prokurori. Është larg të qenit, mendoj unë, nevojës së punës e të bashkëpunimit në grup të Gjykatës Kushtetuese. Aty është një vendimmarrje kolektive dhe shumë e rëndësishme është mënyra e komunikimit, e raporteve, bashkëpunimit, e korrektesës e të qenit të ndershëm në kuptimin e plotë të fjalës për krijimin e raporteve me koleget. Faleminderit .

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shprehet se për të vijuar pak tek pyetja e zj .Tusha. Mbi cilësitë tuaja personale që ju do ti përdornit për një vendimmarrje në kolegjalitet dhe ju gjykoni se i keni, si edhe parimet që gjykoni se duhet tju drejtojnë si gjyqtar kushtetues i ardhshëm potencial gjatë punës tuaj. Çfarë parimesh ju gjykoni se do tju udhëheqin, duke pasur parasysh gjithmonë, për të mos kaluar në përsëritje që vendimmarrja e një prokurori është individuale, është shumë e lidhur me një proces vendimtar, me atë të një organi kolegjal siç është Gjykata Kushtetuese dhe ne prokurorët nuk është se kemi afrimetet të madh me vendimmarrjen kolegjiale. Cilat janë cilësitë tuaja që mendoni se do tu bëjnë të përshtateni dhe ato çka ju do ju drejtojnë?

Kandidati Besnik Muçi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se për të qene efektiv në punën në grup, individi, përveç përgatitjes profesionale të mjaftueshme duhet të ketë dhe ca cilësi individuale, personale, të karakterit të vet. Unë mendoj se nga natyra, nga formimi im, i kam ato cilësi që nevojiten, cilësitë e një personi të kuptueshëm, njeriu që komunikon, që dëgjon, që diskuton, të një njeriu që jep besim. Puna në grup kërkon që të japsh besim dhe të marrësh besim. Unë e kam në natyrë këtë gjë. Punoj me të gjithë oficerët e policisë gjyqësore, të gjithë Republikës së Shqipërisë dhe unë në përgjithësi ju jap besim të plotë në hetim në çështjet penale. Unë i besoj çdo funksionari të shtetit. Dhe ky besim e rrit cilësinë, e rrit efektivitetin. Përveç karakterit tim, këto janë elemente që unë mendoj se ia kam kultivuar vetes gjatë karrierës time që të më lejojnë të jem pjesë e një grupi pune, të një vendimmarrje të rëndësishme, që të jem i kuptueshëm, i dëgjueshëm. E kam aftësinë, durimin edhe të dëgjoj, edhe të diskutoj. Ne kemi pasur diskutime për shembull te zyrat tona të cilat kane zgjatur dhe disa ore për çështjet tona të prokurorisë. Është e rëndësishme që të kesh mundësi të dëgjosh, të debatosh, të japësh argument, të pranosh argument. Unë mendoj se e kam këtë cilësi pavarësisht funksionit. Dhe vijmë tek ajo që tha zonja Tusha kur vijmë në një moment dhe themi boll le të marrim një vendim dhe kjo është një cilësi e rëndësishme e një vendimmarrje, edhe e një anëtari gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Pra në një moment të caktuar duhet të marrësh një vendim të rëndësishëm. Por edhe cilësia tjetër që ti të kesh durim, të dëgjosh argumentet dhe të ndryshosh mendimet e tua me argument. Pra është një cilësi q unë ja kam kultivuar vetes edhe për shkak të seancave të shumta gjyqësore dhe debateve që bëjmë duke dëgjuar palët dhe gjykatën. Është një ndjesi që i krijohet një prokurori apo një gjyqtari. Në lidhje me pyetjen e dytë mbi parimet që do të më drejtojnë. Unë vlerësoj që parimet kryesore që do të drejtojnë funksionin ose një gjyqtar të Gjykatës

Kushtetuese, janë parime që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka përcaktuar. Dhe unë i shpreh ato parime në letër motivimin. Përveç parimeve të korrektesës, ndershmërisë, përkushtimit, profesionalizmit, të qenit i hapur dhe bashkëpunues me të gjithë koleget dhe stafin. Këto janë në formë. Por në përmbajtje, në esencën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese, parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë janë kuadri e korniza tek e cila natyrisht vepron një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Unë i citova. Janë parimet e mbrojtjes dhe promovimit të vlerave, të mbrojtjes së pavarësisë së territorit të Republikës së Shqipërisë, të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, mbrojtjes së institucioneve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të forcimit të pavarësisë dhe eficiencës së sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, të promovimit të vlerave demokratike dhe euroatlantike për shqiptarët. Besoj se këto janë parimet themelore që mendoj që do të më udhëhiqnin mua dhe një anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Fatri Islamaj merr fjalën dhe shprehet se kam një pyetje që ka të bëjë me aspektin menaxhues ose aftësive menaxhuese, duke pasur parasysh karrierën tuaj, një karrierë e pasur dhe si drejtues ose si zëvendësdrejtues edhe si pjesëtar i ekipit të menaxhimit të institucioneve të ndryshme në prokurori apo në administratën e lartë shtetërore, siç është edhe ai rasti kur keni qenë drejtor i drejtorisë së krimit financiar dhe i hetimit financiar në ministri. Në rastin ipotetik të qenies tuaj pjesë e Gjykatës Kushtetuese ose hipotetikusht edhe si drejtues i kësaj Gjykate Kushtetuese në çfarë aspektesh mendoni që mund të përmirësohet puna menaxhuese e Gjykatës Kushtetuese në kuptimin e rritjes dhe në performancën e saj? Në cilat aspekte mendoni që është më shumë e nevojshme të fokusohen energjitë menaxhuese në Gjykatën Kushtetuese?

Kandidati Besnik Muçi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se preka edhe në motivimin tim që aftësia e një anëtari të Gjykatës Kushtetuese, për shkak të mënyrës së organizimit dhe funksionimit e në përmbajtje të ushtrimit të funksionit të menaxhimit të grupit të punës, duhet të ketë mjaftueshmërisht aftësi menaxhuese për të krijuar një ambient normal pune dhe për të nxitur maksimalisht pjestarët e stafit në punë. Unë vlerësoj që duke parur parasysh se kam përvojë 4-5 vjet në funksione të natyrës drejtuese, si drejtues qoftë dhe si zëvendësdrejtues institucioni. Është e rëndësishme që stafi i një institucioni të ndihet i lire dhe i pavarur në kuptimin e përgjegjësive, të ketë një regjim kontrolli dhe disipline në një e funksion të tillë, që të mos i ngarkoj psikologjikisht dhe të frenojë gjithë institucionin në ushtrimin e përgjegjësive për punët e përditshme nga pikëpamja e ngushtë administrative. Pjesa e dytë e pyetjes ku mund dhe si mund, ku janë drejtimet kryesore që mund të përmirësoj apo ndryshoj unë. Unë mendoj se

Gjykata Kushtetuese është si institucion , si këto makineritë më të rënda të ndërtimit, të cilat po i vure në lëvizje është e vështirë ti frenosh. Por duke folur në një parim të përgjithshëm, në një princip të përgjithshëm , duke pasur në konsideratë edhe dinamikën e zhvillimeve shumë të rëndësishme kushtetuese dhe institucionale të viteve të fundit, Gjykata Kushtetuese do ketë një përgjegjësi të konsiderueshme, ashtu siç kanë të gjitha institucionet me përgjegjësi të rëndësishme. Por përgjegjësia e Gjykatës Kushtetuese është e veçantë, është unike dhe në këtë prizëm do të duhet të lëvizë, të jetë dinamike, ti përgjigjet në kohë nëpërmjet ushtrimit të funksioneve kushtetuese, brenda funksionit të vet, të gjitha zhvillimeve dhe nevojave të shoqërisë shqiptare, të institucioneve të shoqërisë shqiptare. Pra unë kujtoj p.sh., rastet e Prokurorit të Përgjithshëm që vendimtarja mbetet e pazbatuar. Në këtë sens Gjykata Kushtetuese mendoj që duhet të marrë përgjegjësinë që i jep Kushtetuta që të luajë rolin e saj kushtetues në të gjithë dinamikën e zhvillimeve në vendin tonë. Aq më shumë duke pasur në konsideratë që ne kemi dinamikë në vitet e fundit dhe do të ketë dinamikë për shkak të implementimeve të ndryshimeve kushtetuese. Besoj se do të ketë dinamike të konsiderueshme në punën e Gjykatës Kushtetuese. Kjo mund të jetë një element ku Gjykata Kushtetuese mund të bëjë një farë ndryshimi në këtë sens .

Ardian Dvorani merr fjalën dhe shtron pyetjen se çfarë nuk shkon në Gjykatën Kushtetuese sot? Çfarë problemesh ka? Si e mendoni ju, si është performanca e Gjykatës Kushtetuese deri me sot ? Nuk është një çështje për perceptimin e individëve por për gjykatën si institucion. Pra a e ka përmbushur misionin e saj? Aty ku nuk ka ecur si duhet ecur? Përse nuk ka ecur? Në çdo fushë themi se çfarë nuk na shkon në punën tonë. Mendoni sikur të jeni në atë zyrë. Çfarë nuk shkon?

Kandidati Besnik Muçi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se fakti që të gjithë aktoret institucionale, politike, individuale, në Shqipëri gjatë gjithë këtyre viteve, por në veçanti gjatë periudhës së fundit, i referohem në krye të herës për çdo situatë si gjithmonë Gjykatës Kushtetuese, pra i referohem zgjidhjes, vendimmarrjes së këtij institucioni, tregon që pavarësisht mendimeve dhe interpretimeve për veprimtarin e saj, këto mekanizma institucionale, individuale, politike në Shqipëri ende kanë besim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Pra i referohen jo thjesht proceduralisht si instanca e fundit e zgjidhjes së konflikteve me natyrë kushtetuese, por e kanë edhe besimin tek Gjykata Kushtetuese. E kam të vështirë vërtet të vlerësoj se çfarë nuk shkon, nëse ka element të tjerë të thjeshtë administrative. Por nga

pikëpamja e performancës publike ende ky është institucion i fundit që i besojnë shqiptarët. E kam vështirë të them, por ndoshta ajo që thash pak më sipër, veprimtaria në mënyre dinamike e në koherencë me zhvillimet. Kjo mund të jetë një element që Gjykata Kushtetuese ta ushtroj funksionin e vet në mënyrë pak më eficiente në vendimmarrjen e vet.

Ardian Dvorani merr fjalën dhe shtron pyetjen se në mënyrë të përmbledhur, cili është mendimi juaj, cilat janë arsyet që institucionet tona konfliktohen ashpër dhe ku është roli i Gjykatës Kushtetuese në këtë mes? A ka kontribuar sa duhet dhe a mund të kontribuoj sa duhet? Kushtetuta e parashikon, në çdo vend demokratik të kuptohemi, që Gjykata Kushtetuese e ka një kompetencë të natyrshme të saj që të zgjidhë konflikte, por për diçka më specifike, tek ne, duke qenë se ju mund të jeni një nga gjyqtaret: Cili është mendimi juaj, pa e lidhur me raste konkrete, përse kaq të ashpra konfliktet institucionale tek ne dhe a ka mundur Gjykata Kushtetuese dhe a mundet të kontribuojë ashtu siç e parashikon Kushtetuta që ti zgjidhim këto përplasje?

Kandidati Besnik Muçi, përgjigjet se unë këtë e kam konsideruar si sfidën kryesore të Gjykatës Kushtetuese. Pra kur them që është sfidë madhore konsolidimi i shtetit ligjor dhe ndërtimi i institucioneve demokratike. Ne kemi institucione, Shqipëria ka institucione demokratike të krijuara në mënyrë demokratike, të mbështetura në Kushtetute por konsolidimi i këtyre institucioneve është shumë i rëndësishëm. Vlerësoj që edhe Gjykata Kushtetuese, në këtë situatë kaq të ashpër konfliktuale institucionale në Shqipëri, ka rolin e vet, ka përgjegjësinë e vet. Sepse mendoj që reagimi i shpejtë, në mënyrë të argumentuar e të menjëhershme nga Gjykata Kushtetuese në situata të caktuara, mund të bëj që duke pasur parasysh autoritetin dhe pozicionin funksional, kushtetues dhe autoritetin e plotë të saj në vendimmarrje, aktoret e tjerë nuk mund të diskutojnë më dhe mund të shërbej si një mekanizëm që të ulë situatën e acaruar konfliktuale institucionale brenda shtetit shqiptar. Fakti që për një periudhe të gjatë kohe nuk është duke ushtruar funksionet dhe situata institucionale, sikurse edhe ju thatë është vërtet shumë e acaruar, tregon se roli i Gjykatës Kushtetuese është vendimtar. Mundet që edhe me një Gjykatë Kushtetuese funksionale situata të jetë prapë e acaruar. Por një Gjykatë Kushtetuese funksionale, vendimmarrëse, efiçente, koherente mendoj se do të ndikonte jashtëzakonisht pozitivisht në uljen e kësaj klime në Republikën e Shqipërisë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi vëren se nuk ka pyetje te tjera, orienton vijimin e intervistës, në pjesën e dytë të saj, lidhur me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të

huaja. Ekspertja që është e pranishme tani do të marrë fjalën dhe do të jetë ajo që do të zhvillojë bisedën për aq sa ajo e vlerëson të arsyeshme.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani fton ekspertin, zj. Adelina Brahimë për të vazhduar intervistën me kandidatin Besnik Muçi.

Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi zhvillon bisedën e lirë dhe me pyetje përgjigje me kandidatin Besnik Muçi në gjuhën angleze (koha e kësaj pjese të intervistës 11.45.04–11.55.37)

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani në përfundim të pjesës së intervistës në gjuhën angleze, e njofton kandidatin Besnik Muçi për përfundimin e intervistës dhe e falënderon së pari për nismën për të kandiduar në vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese dhe për seriozitetin me të cilën e zhvilloi bisedën me Këshillin.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 9 Gusht, në orën 10.00, me rendin e ditës së dakordësuar në këtë mbledhje, për diskutimin dhe vendimmarrjen në lidhje me shpalljen e fillimit të procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, për sa i përket vendeve vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, atë nga Kuvendi në datën 28.08.2018, si edhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, duke vijuar më pas relatimin për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës dhe zhvillimi i intervistave, sipas ligjit, me kandidatët e lejuar për vendet vakante; deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 12.05

Sekretare

Dorina Dulaj
Ermelinda Kadiu
Redjona Myrtja

Kryetari

Ardian Dvorani